MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

midis

Kolegjit ''UNIVERSUM''- Prishtinë

Dhe

Vision Agency - Prishtinë

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

II. Fusheveprimtaria

1. Me anë të këtij memorandumi, Vision Agency punëson 20 studentë të Kolegjit Universum me orarë gjysëm të plotë (Maximum 20 orë në javë), dhe në këtë mënyrë bënë ndërlidhjen midis teorisë dhe praktikës.
2. Vision Agency do të paguaj secilin studentë €100 (bruto) në muaj gjatë tri viteve të studimit.
3. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, palët dakordohen që të bëjnë shkëmbimin e stafit **(në raste të caktuara)** për pjesëmarrje në ligjërata publike apo evenimente të organizuara në frymën profesionale.
4. Kolegji Universum do të përditësoj kurrikulat e programeve akademike në mënyrë që ato të përshtaten me nevojat e kompanisë Vision Agency dhe të industrisë.
5. Sipas nevojës, Kolegji Universum do të punësoj stafin e Vision Agency si ligjerues në departamentet përkatëse.
6. Kolegji Universum do të ofron ndihmë akademike me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të Vision Agency.

III. Përzgjedhja e Kandidatëve

1. Përzgjedhja e studentëve të cilët do të punësohen me orarë gjysëm-të-plotë do të bëhet nga Kolegji Universum në bashkëpunim me Vision Agency. Procesi i përzgjedhjes do të organizohet në 3 faza: (I) Shpallja e konkursit në të gjitha platformat e Kolegjit Universum; (II) Organizimi i Testit me

shkrim në fusha të ndryshme; dhe (III) Intervistat individuale. Kandidatët e përzgjedhur do të nënshkruajnë kontratë individuale me Vision Agency dhe Kolegjin Universum ku specifikohen të gjitha obligimet e palëve kontraktuese.

IV. Kohëzgjatja e Bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi midis Kolegjit Universum dhe Vision Agency për implementimin e fushave të cekura në Pikën II do të zgjas për 5 vite. Gjatë kësaj periudhe Kolegji Universum nuk do të nënshkruaj marrëveshje të ngjashme me kompani vendore. Gjithashtu, Vision Agency nuk do të nënshkruaj marrëveshje për punësimin e studentëve me gjysëm-orarë me pagesë me institucione të arsimit të lartë në Kosovë.

V. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij memorandumi, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë;

3. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

4. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

PALËT NËNSHKRUESE

Prishtinë, më 26 Korrik, 2018

Kolegji ''UNIVERSUM''
Alejtin Berisha
Drejtor Ekzekutiv

KOLEGJI UNIVERSUM * UNIVERSUM * PRISHTINË

Vision Agency
Fazli Kabashi
Drejtor Ekzekutiv